



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.244/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 01.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248, Anr.249, Anr.250, Anr.257/2025, Anr.258/2025, të datës 29.01.2025 dhe Anr.267/2025, Anr. 268/2025, të datës 30.01.2025.
- II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 35,000.00 (tridhjetepesëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 29.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.243/2025, Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248, Anr.249, Anr.250/2025, Anr.257/2025, Anr.258/2025, dhe me datë 30.01.2025 Anr.267/2025, Anr.268/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesën Anr.244/2025, me datë 27 janar 2025 kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje aktualisht edhe kryetar i këtij subjekti politik si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka deklaruar *...jemi duke i hequr qafe, duke i pensionuar, dukë i eliminuar nga skena e pushtetit*

politikanët, himni i të cilëve nuk është rreth flamurit të përbashkuar, por rreth korrupsionit të përbashkuar, të dashur qytetare të Drenasit ata i ka bashkuar korrupsioni. Ata po i ndanë e po i përçan para e placitur dhe zhvatur nga korrupsioni i tyre i përbashkët. Pra edhe një herë korrupsionin e kishin të përbashkët, por para po i ndanë e po i përçanë prandaj ata që ishin të pabesë janë bërë edhe të pashpresë”. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD, me përmbajtje të videoincizimit të fjalimit, si dhe ftesë publike të publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

-Në ankesën Anr.245/2025 pretendohet se me datë 28 Janar 2025 kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj.Albulena Haxhiu, ka postuar në profilin e saj në rrjetin social në facebook, deklarim me përmbajtje se gjuhës nxitëse dhe urrejtse ndaj antarëve të PDK-së duke deklaruar ...Sami Lushtaku mbremë personalisht ka tentuar ta sulmojë eskortën e Kryeministrit. Ai me veturë zyrtare, 02Z të Komunës së Skenderajt e ka pre rrugën e Kryeministrit më qëllim sulmi. Dëgjova që disa gazetarë të Klan Kosovës, e kanë pyetur kryeministrin se po i përdor veturat zyrtare, ndoshta është më mirë me e pyet Saminë se prej së cilës pompë të benzinës i ke komandu Huliganët e tu para se të nisesh si i frustuar. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i shpërndarë në profilin e rrjetit social Facebook, me përmbajtje të gjuhës nxitëse, përqarëse dhe denigruese ndaj anëtarëve të Partisë Demokratike të Kosovës <https://www.facebook.com/albulenaa.haxhiuu/posts/pfbid02AE93JuooPmYbYqPokGHNaU7395MmGfJ96QP7iF13gp981MptVtBxeb4vh3B3BUydI>; Screenshoot i postimit nga znj. Albulena Haxhiu në të cilën argumentohet koha dhe data e shpërndarjes së postimit me përmbajtje të gjuhës nxitëse dhe përqarëse.

Në ankesë Anr.246/2025 pretendohet se me 28 janar 2025, kandidati për deputetë nga radhët e LVV z. Dimal Basha ka publikuar në status në rrjetin e tij social në facebook në të cilin shkruan: *Vota për PDK është vetëm fuqizim për Sami Lushtakun e që Kosovës nuk i duhen më politikanë që sillen si bandita. Kosova nuk i duron më Banditat.* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur statusi i publikuar në profilin e z. Dimal Basha në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/dimalbasha/posts/pfbid0XU6Tb3m3tEKhRzNs5tjps8KGNQsFIÉgDPKG4mJAmAXaRTYCnpuVuoJ0E9BdPIeD71>, dhe screenshot nga statusi i publikuar në profilin e rrjetit social Facebook i z.Dimal Basha.

-Në ankesën 248/2025, pretendohet se me 27 janar 2025 në tubimin e mbajtur në Komunën e Skenderajt janë publikuar disa fotografi, në rrjetet sociale dhe mediat elektronike të mbështetësve të LVV, të mbledhur në këtë tubim, duke ngritur tre gishta lartë, gjest i cili është simbol ekskluziv serb, i cili në tre vitet e fundit ka marr ngjyrimet nacionaliste, pasi u përdor nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në Ballkan. Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur *Fotografia e publikuar nga tubimi i mbajtur në Komunën e Skenderajt, dhe ftesën e njoftuar nga subjekti politik LVV, për tubimin në Komunën e Skenderajt.*

Në ankesën Anr.249/2025 pretendohet se me datë 28 janar 2025 kandidatja për deputete nga radhët e LVV, znj. Fitore Pacolli ka postuar në profilin e saj në facebook video incizim më

përmbajtje të gjuhës urrejtëse ndaj subjektit politik PDK duke deklaruar se ...*Turma e madhe e qytetareve kishin dal në mbështetje të Kryeministrit Kurti, e ca huliganë të angazhuar nga PDK-ja, tentuan ti ndalojnë. Por ja që qytetarët e Skenderajt kanë vendosur ndryshe e do të vendosin ndryshe pra kësaj radhe ata do votojnë për Qeverinë më të mirë që ka pasur Kosova, pra qeverinë Kurti. Ata nuk janë peng i liderëve që kërcënojnë e i shantazhojnë për interesat e tyre politike.* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD me video incizimin e publikuar në profilin e rrjetit social Facebook, nga znj. Fitore Pacolli, të cilat përmbajnë deklarata me përdorim të gjuhës nxitëse dhe urrejtëse ndaj subjektit politik PDK; <https://www.facebook.com/fitorepacollidalipi/videos/2350588898630621>, dhe screenshot i postimit të publikuar nga znj. Fitore Pacolli.

-Në ankesën Anr.250/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 mbështetësi i subjektit politik LVV, aktualisht asistent personal i ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes z. Afrim Berisha ka publikuar një status në profilin e tij në facebook në të cilin shkruan "*Mjerranët e bandave të PDK-së, njëzëri u përgjigjen: Familjes Jashari atyre po u shesim trimëri. Bandat e PDK-së, i kanë varfëruar qytetarët në Drenicë, prandaj i manipulojnë e po i përdorin për interesat e tyre. Pyetni bandat pasi jeni kaq të fortë se si është e mundur që midis Drenice të ketë komunë paralele serbe, si është e mundur që asnjë organizim asnjë protestë nuk u organizua për largimin e tyre, se për gjuajtje të kallashnikovit as që bëhet fjalë. Pyetni Bandat e PDK-së pse u dashtë të vijë Albin Kurti në pushtet për tua larguar Beogradin nda dera e shtëpisë. Pyesni bandat nëse mund të përgjigjen.....Nuk ka banda të kujtdo qofshin që mund të ndalin fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Kryeministrit Albin Kurti*". Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë : Statusi i publikuar në profilin e z. Afrim Berisha në rrjetin socialFacebook;<https://www.facebook.com/Afrimberishaa/posts/pfbidOWakqa9ZV7qqroPhU6R4t8EdHfvMQKBgmpPhvzkrViaFCu2z85zUA9aqM9NqWXIvYl>, dhe screenshot nga statusi i publikuar në profilin e rrjetit social facebook të z.Afrim Berisha.

Në ankesën Anr.257/2025, pretendohet se më datë 27 janar 2025, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik LVV, aktualisht ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka deklaruar: "*...ani pse Qeveritë e kaluara thirrreshin në emër të luftës, asnjëherë nuk bën asgjë për luftën, përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës sepse Kosova ska bëre krime lufte por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar, por edhe nga Drenasi iu kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, të kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika, sepse qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen, më Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelët siç kishte amnisti në të kaluarën.* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD me përmbajtje të video incizimit të fjalimit në tubimin e mbajtur nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Drenas, në të cilën, znj. Albulena Haxhiu përdorë shprehje fyese, urrejtëse, denigruese, përçarëse dhe nxitëse ndaj subjekteve, dhe Ftesa publike e publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

-Në ankesën 258/2025, parashtruesi i ankesës pretendon se me datë 27 janar 2025, kandidati për deputetë nga radhët e LVV, aktualisht ministër i Ministrisë së Bujqësisë z.Faton Peci në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim ka deklaruar : *Me datën 9 shkurt Kosova ka dy opsione para vetës. Edi se presioni është i madh dhe*

mediatik edhe i atyre të cilët po fusin me investimet e fundit krejt parat e pista për të parandaluar dhe njëherë Albin Kurtin të fitoj i vetëm bashkë me Guxo dhe Alternativën mandatin e ardhshëm të Qeverisjes dhe rrjedhimisht janë duke realizuar një presion të paparë cep më cep të Kosovës por këtë presion cep më cep të Kosovës nuk e bëjnë që Kosovën ta kenë shtet me sovranitet cep më cep, por se ata kanë mbetur keq në xhepat e tyre atje ku kanë dashur me nda cop më cop. Rrjedhimisht unë mendoj që Drenica e heroizmit, sakrificës flijimit por edhe e krenarisë nuk do ti besoj atyre që e kanë konsideruar dhe e vlerësojnë veriun e Kosovës si dhuratë e Rankoviqit. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Provë: CD me përmbajtje të video incizimit të fjalimit në tubimin e mbajtur nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën Drenas, në të cilën, z. Faton Peci përdorë shprehje fyese, urrejtëse, denigruese, përçarëse dhe nxitëse ndaj subjekteve kundërshtarë politike, dhe Ftesa Publike e publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

-Në ankesën Anr.267/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 00:57 Selvije Berisha mbështetësja e subjektit politik Vetëvendosje, anëtarë e LVV-së që nga 12 dhjetori 2024 ka shpërndarë një fotografi në grupin Vetëvendosje, në rrjetin social facebook me tekst shoqërues: *"Kur po ju them që Sami Lushtaku është kriminel dhe mafioz ju po më shani në privat. Vota për Bedriun është shpëtim për Saminë.* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar nga znj. Selvije Berisha, fotografia e shpërndarë në rrjetin social Facebook, në grupin Vetëvendosje!, ku dëshmohet edhe koha dhe data e publikimit të postimit; Të dhënat nga rrjeti social Facebook, ku dëshmohet se e njëjta është anëtare e Lëvizjes Vetëvendosje nga data 12 dhjetor 2024;

-Në ankesën Anr.268/2025 pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 19:45 mbështetësja e subjektit politik LVV, aktualisht Koordinate e Komuniteteve në Lëvizjen Vetëvendosje znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrjetin social facebook në të cilin shkruan : *"a shkoj sot në Klinë të Epërme të Skenderajt, kandidati i PDK-së Bedri Hamza", Me Saminë bashkë a vetëm? Ende asnjë distancim nga huliganizmi drejtuar nga Sami Lushtaku, as shtabi i PDK-së as kandidati i PDK-së. Programi "treni elektrik" realiteti banditizmi".* Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur postimi i publikuar në profilin e znj. Dejana Mihali në rrjetin social në Facebook, <https://www.facebook.com/dejana.mihali/posts/pfbid02uaebz1uvK84g4VxW661uXsNdAYMoNpkxb7cie4vaKiHrRbAsrPsfKDvn4vWLtWSD/>.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje theksohet si në vijim:
Në përgjigjen për ankesën Anr.244/2025 të datës 30.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, vlerëson se ankesa është e pabazuar për faktin se e njëjta nuk përmban ndonjë fakt apo provë që ndërlidhet me shkeljen e pretenduar, si dhe e njëjta nuk është drejtuar subjektit konkret në këtë rast PDK-së, andaj PDK vetë aludon në vetveten kur përmendet korrupsioni. Pra z. Kurti në deklaratën e tij në asnjë çast nuk thekson subjektin e pretenduesit, në këtë rast PDK-së.

Në përgjigjen për ankesën Anr.245/2025 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV të njëjtën e ka vlerësuar si të pabazuar me pretendimin se nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte deklaratën/veprimin e përshkruar si shkelje dhe se deklarata e znj Haxhiu, në llogarinë e saj në facebook është vetëm përshkrim i një situatë e cila u pengua nga aktivistë të PDK-së, për mbajtjen e tubimit dhe lëvizjen e lirë të Kryeministrit më eskortën shoqëruese.

Në përgjigjen për ankesës Anr.246/2025, të subjektit politik LVV, e njëjta e ka refuzuar si të pabazuar për faktin se njëjta nuk përmban shkelje me pretendimin se Sami Lushtaku me mbështetës tjerë të PDK-së, kanë çrregulluar tubimin e LVV-së, në Skenderaj, kanë kërcënuar qytetarët brenda tubimit të LVV-së, dhe se lidhur me këtë ka fakte siç është fakti i arrestimit të personit Lavdim Jashari përkrasës i PDK-së. Pra deklarata e kandidatit Basha në llogarinë e tij në facebook, e ardhur pas veprimeve të lartcekura të mbështetësve të PDK-së, nuk është asgjë tjetër pos një përshkrim i një situatë të shoqëruar me veprimet penguese të këtyre anëtarëve dhe aktivisteve të subjektit përkatës PDK për mbajtjen e tubimit.

Në përgjigjen për ankesën 248/2025 të LVV-së, pretendohet se shkrimi i bashkangjitur në fotografi nuk dëshmon asgjë as vendin as personin që do të ndërlidhte me subjektin LVV, madje për një vrojtues të rëndomte ndoshta mund të dakordohemi se vetëm një flamur vërehet mirëpo asgjë tjetër lidhur me gjendje faktike.

Në përgjigjen për ankesës Anr.249/2025, të subjektit politik LVV, theksohet se deklarata e kandidates në llogarinë e saj në facebook është në përputhje me rregullativën zgjedhore, ishin aktivistët dhe mbështetësit e PDK-së, ata të cilët kanë çrregulluar tubimin e LVV-së, në Skenderaj duke kërcënuar qytetarë brenda tubimit të LVV si provë është edhe fakti i arrestimit të mbështetësve të PDK siç është Lavdim Jashari.

Në përgjigjen për ankesën Anr.250/2025, të subjektit politik LVV, theksohet se deklarata e kandidatit në llogarinë e tij në facebook është në përputhje me rregullativën dhe frymën e një fushatë zgjedhore. Mbështetësit dhe aktivistët e PDK-së, kanë çrregulluar tubimin e LVV, në dhe lidhur më këtë tashmë ka fakte siç është arrestimi i mbështetësve të PDK-së. Pra sipas parashtruesit të përgjigjes në ankesë deklarata e këshilltarit Berisha nuk është gjë tjetër veçse përshkrimi i një situatë.

Në përgjigjen për ankesën Anr.257/2025 të subjektit politik LVV theksohet se sa i përket deklaratës *“Përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës, sepse Kosova ska bëre krime lufte, por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar por edhe nga Drenasi, u kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, te kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika sepsë qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen,* Ministra vetëm ka theksuar një fakt dhe një të vërtetë dhe një deklaratë të dhëne më parë nga vet Sekretarja e PDK-së znj. Vlora Çitaku, jo vetëm njëherë por shumë herë lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale e cila kishte deklaruar se janë edhe ndjeshëm të mashtruar. Ndërsa sa i përket deklaramit *“me Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelet, siç kishte amnisti në të kaluarën”* e njëjta vetëm se e rithekson një veprim dhe fakt të subjektit përkatës politik.

Në përgjigjen për ankesën Anr.258/2025 të subjektit politik LVV, ka theksuar se Ministri Peci në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka përmendur fakte të cilat janë të ditura dhe të përmendur nga vetë subjekti përkatës PDK, këto deklarata të cilat tashmë janë deklarata notore nga vet akterë të rëndësishëm të këtij subjekti PDK-së Hashim Thaçi.

Në përgjigjen për ankesën Anr.267/2025, lidhur me pretendimet se personi i ashtuquajtur Selviqe Berisha, është një mbështetëse dhe aktiviste e Lëvizjes VETEVENDOSJE! konfirmojmë si LVV, se personi i tillë nuk figuron si anëtarë apo aktivistë/ mbështetëse e LVV-së. Për më shumë, bazuar në provat e ofruara nga pretenduesi, në asnjë moment nuk

vërehet se Llogaria e tillë në facebook, të jetë si llogari reale e personit në fjalë dhe e cila do të ndërlidhej me shkeljen e supozuar të parashtruesve.

Në përgjigjen për ankesën Anr.268/2025 në pjesën e parë të këtij postimi znj. Dejana Mihali ka thënë: "A shkoi sot në Klinë të epërme të Skenderaj, Kandidati i PDK-së Bedri Hamza? Me Saminë bashkë a vetëm", e ka ngritur pyetjen e cila në vetvete nuk përmban asnjë nga veprimet e ndaluara në bazën ligjore të cekur nga ankuesi, konkretisht neni 34 par 1 nën par 1.11 i LZP-së, që për bindjen e lirë dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Neni 40), e njëjta ka të drejtë të aludoj se z. Bedri Hamza nuk shkon në bastionet e PDK në Skenderaj pa Sami Lushtakun që i përket me prejardhje asaj ane të Kosovës.

Në pjesën e dytë znj. Dejana Mihali shprehet: "Ende asnjë distancim nga huliganizmi i drejtuar nga Sami Lushtaku as shtabi i PDK-së as Kandidati i PDK-së.", ku ka kërkuar distancim nga subjekti politik PDK për veprimet të cilat nga indiciet e forta lënë hapësirë për dyshim se kanë ndodhur pikërisht nga përkrahësit e PDK (fjala është për incidentin në Skenderaj për të cilin është në dijeni edhe PZAP për shkak të shumë ankesave nga subjektet lidhur me këtë ngjarje), pra znj. Mihali kërkon që ky subjekt të distancohet dhe të vetë deklarohej se nuk kanë të bëjnë me ngjarjen, konsiderojmë se edhe kjo pjesë e deklaratës së zonjes Mihali është legjitime dhe e drejtë e saj që të kërkoj nga një subjekt i certifikuar nga KQZ dhe që përfaqëson një pjesë të popullatës në Kuvendin e Kosovës, që të distancohet nga veprimet banditeske ashtu siç ajo i ka quajtur dhe ashtu siç ato veprime në të vërtetë edhe janë. Deklarata (postimi) objekt i kësaj ankese, nuk është i drejtuar nga PDK, por është i drejtuar nga huliganët e natës së 27 janarit ku edhe ndodhi incidenti në Skenderaj.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248, Anr.249, Anr.250, Anr.257/2025, Anr.258/2025, të datës 29.01.2025 dhe Anr.267/2025, Anr. 268/2025, të datës 30.01.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.244/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidatët dhe simpatizant të subjektit politik LVV, dhe atë: **Albin Kurti**, Kandidat për deputet dhe njëherit Kryeministër i Republikës së Kosovës në Drenas në tubimin e mbajtur ka deklaruar:

“jemi duke i hequr qafe, duke i pensionuar, duke i eliminuar nga skema e pushtetit politikanët, himni i të cilëve nuk është rreth flamurit të përbashkuar, e të dashur qytetarë të Drenasit ata i ka bashkuar korrupsioni”, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj. **Albulena Haxhiu**, ka postuar në profilin e saj në rrjetin social në facebook, d eklarim me përmbajtje se gjuhës nxitëse dhe urrejtëse ndaj anëtareve të PDK-së duke deklaruar ...*Sami Lushtaku mbrëmë personalisht ka tentuar ta sulmojë eskortën e Kryeministrit. Ai me veturë zyrtare, 02Z të Komunës së Skenderajt e ka pre rrugën e Kryeministrit më qëllim sulmin. Dëgjova që disa gazetarë të Klan Kosovës, e kanë pyetur kryeministrin se po i përdor veturat zyrtare, ndoshta është më mirë me e pyet Saminë se prej së cilës pompë të benzinës i ke komandu Huliganët e tu para se të nisësh si i frustuar*” kandidati për deputetë nga radhët e LVV z. **Dimal Basha** ka publikuar në status në rrjetin e tij social në facebook në të cilin shkruan “*Vota për PDK është vetëm fuqizim për Sami Lushtakun e që Kosovës nuk i duhen më politikanë që sillen si bandita. Kosova nuk i duron më Banditat: Në tubimin e mbajtur në Komunën e Skenderajt janë publikuar disa fotografi në rrjetet sociale dhe mediat elektronike të mbështetësve të LVV, të mbledhur në këtë tubim, duke ngritur tre gishta lartë, gjest i cili është simbol ekskluziv serb, i cili në tre vitet e fundit ka marr ngjyrimet nacionaliste, pasi u përdor nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në ballkan; kandidatja për deputete nga radhët e LVV, znj. **Fitore Pacolli** ka postuar në profilin e saj në facebook videoincizim me përmbajtje të gjuhës urrejtëse ndaj subjektit politik PDK duke deklaruar se ...”*Turma e madhe e qytetarve kishin dal ne përkrahje të Kryeministrit Kurti e ca huliganë të angazhuar nga PDK-ja tentuan ti ndalojnë. Por ja që qytetarët e Skenderajt kanë vendosur ndryshe e do të vendosin ndryshe pra kësaj radhe ata do votojnë për Qeverinë më të mirë Kurti. Ata nuk janë peng i liderëve që kërcënojnë e i shantzhojnë për interesat e tyre politike*”, Mbështetësi i subjektit politik LVV, aktualisht asistent personal i ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes z. **Afrim Berisha** ka publikuar një status në profilin e tij në facebook në të cilin shkruan “*Mjeranët e bandave të PDK-së, njëzëri u përgjigjen: Familjes Jashari atyre po u shesim trimëri. Bandat e PDK-së i kanë varfëruar qytetarët në Drenicë, prandaj i manipulojnë e po i përdorin për interesat e tyre. Pyetni bandat pasi jeni kaq të fortë se si është e mundur që midis Drenice të ketë komunë paralele serbe, si është e mundur që asnjë organizim asnjë protestë nuk u organizua për largimin e tyre, se për gjuajtje të kallashnikovit as që bëhet fjalë. Pyetni Bandat e PDK-së pse u dasht të vijë Albin Kurti në pushtet për tua larguar Beogradin nda dera e shtëpisë. Pyesni bandant nëse mund të përgjigjen.....Nuk ka banda të kujt qofshin që mund të ndalin fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Kryeministrit Albin Kurti*”, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik LVV, aktualisht ministër në Ministrinë e Drejtësisë znj. **Albulena Haxhiu** në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka deklaruar: “*...ani pse Qeveritë e kaluara thirreshin në emër të luftës, asnjëherë nuk bënë asgjë për luftën, përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës sepse Kosova ska bëre krime lufte por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar, por edhe nga Drenasi iu kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, të kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika, sepse qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen, më Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelët siç kishte amnisti në të kaluarën*”, kandidati për deputetë nga radhët e LVV, aktualisht ministër i Ministrisë së Bujqësisë z. **Faton Peci** në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim ka deklaruar : *Me datën 9 shkurt Kosova ka dy opsione para vetës. Edë se presioni është i madh dhe mediatik edhe i atyre të cilët po fusin me investimet e**

fundit krejt parat e pista për të parandaluar dhe njëherë Albin Kurtin të fitoj i vetëm bashkë me Guxo dhe Alternativën mandatin e ardhshëm të Qeverisjes dhe rrjedhimisht janë duke realizuar një presion të paparë cep më cep të Kosovës por këtë presion cep më cep të Kosovës nuk e bëjnë që Kosovën ta kenë shtet me sovranitet cep më cep, por se ata kanë mbetur keq në xhepat e tyre atje ku kanë dashur me nda cop më cop. Rrjedhimisht unë mendoj që Drenica e heroizmit, sakrificës, flijimit por edhe e krenarisë nuk do ti besoj atyre që e kanë konsideruar dhe e vlerësojnë veriun e Kosovës si dhuratë e Rankoviqit". Selville Berisha mbështetësja e subjektit politik Vetëvendosje, anëtare e LVV-së, që nga 12 dhjetori 2024 ka shpërndarë një fotografi në grupin Vetëvendosje, në rrejtin social facebook me tekst shqërues: "Kur po ju them që Sami Lushtaku është kriminel dhe mafioz ju po më shani në privat. Vota për Bedrin është shpëtim për Saminë", mbështetësja e subjektit politik LVV aktualisht Koordinatore e Komuniteteve në Lëvizjen Vetëvendosje znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrejtin social facebook në të cilin shkruan: "a shkoj sot në Klinë të Epërme të Skenderajt, kandidati i PDK-së Bedri Hamza", Me Saminë bashkë a vetëm? Ende asnjë distancim nga hulumtuesit drejtuar nga Sami Lushtaku, as shtabi i PDK-së as kandidati i PDK-së. Programi "treni elektrik" realiteti banditizmi".

Paneli vlerëson se gjuha e përdorur si më lartë nga kandidatët për deputet, mbështetësit dhe simpatizuesit e LVV se është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektin politik PDK dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Sipas Panelit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik PDK, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se deklaratimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë polarizim të elektoratit, të krijojnë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes, të acaroj rivalitetin politik. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime apo deklarime që mund të sjellin pasiguri, destabilitet apo të përkeqësojnë atmosferën politike në përgjithësi, njëkohësisht janë të obliguar të respektojnë dinjitetin dhe integritetin e të tjerëve. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimet e tilla përbëjnë përsëritje të shkeljeve për nga natyra, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që

konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Duke pas parasysh se Rregullorja 01/2024, dhe dispozitat e LZP, neni 120 paragrafi 1 nën paragraf 1.3 për shkelje të tilla parashohin dënimin me gjobe deri në 50.000 euro, Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë në mënyrë të përsëritur.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa


Anr.244/2025 më datën 01.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



A.A.nr.32/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A nr.244/2025, të datës 01.02.2025, në seancën e mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET pjesërisht e themeltë ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dhe NDRYSHOHET pjesërisht vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, përkatësisht pika I dhe II, dhe vendoset si në vijim: I. Refuzohen të pabazuara ankesat e parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.244/2025, Anr.257/2025, dhe A.nr.258/2025, të gjitha të datës 29.01.2025, dhe II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i zbritet dënimi i shqiptuar me gjobë nga 35,000.00 (tridhjetë e pesë mijë) €, në lartësi prej 25,000.00 (njëzet e pesëmijë) €.

REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, në pjesën tjetër të dispozitivit, përkatësisht në pikën I. lidhur me ankesat: A.nr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248/2025, A.nr.249/2025, Anr.250/2025, A.nr.267/2025, Anr.268/2025, dhe pikën III, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, është vendosur: I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248, Anr.249, Anr.250, Anr.257/2025, Anr.258/2025, të datës 29.01.2025 dhe Anr.267/2025, Anr.268/2025, të datës 30.01.2025. II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 35,000.00 (tridhjetëpesëmijë) euro. III. Detyrohet Subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për



shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, gjëja nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ndërsa vendimin Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, ta anuloj, ashtu që ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ta refuzojë.

PZAP, në përgjigje në ankesën kundër vendimit të lartpërmendur të ankimuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi Anr.244/2025, të datës 01.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.01.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248, Anr.249, Anr.250/2025, Anr.257/2025, Anr.258/2025, dhe me datë 30.01.2025 Anr.267/2025, Anr.268/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Në ankesën Anr.244/2025, me datë 27 janar 2025 kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje aktualisht edhe kryetar i këtij subjekti politik si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka deklaruar “... jemi duke i hequr qafe, duke i pensionuar, dukë i eliminuar nga skena e pushtetit politikanët, himni i të cilëve nuk është rreth flamurit të përbashkuar, por rreth korrupsionit të përbashkuar, të dashur qytetare të Drenasit ata i ka bashkuar korrupsioni. Ata po i ndanë e po i përçan paraja e plaçkitur dhe zhvatur nga korrupsioni i tyre i përbashkët. Pra edhe një herë korrupsionin e kishin të përbashkët, por paraja po i ndanë e po i përçanë prandaj ata që ishin të pa besë janë bërë edhe të pashpresë”.

Në ankesën Anr.245/2025, pretendohet se me datë 28 Janar 2025 kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu, ka postuar në profilin e saj në rrjetin social në facebook, deklarim me përmbajtje të gjuhës nxitëse dhe urrejtje ndaj anëtarëve të PDK-së duke deklaruar “...Sami Lushtaku mbrëmë personalisht ka tentuar ta sulmojë eskortën e Kryeministrit. Ai me veturë zyrtare, 02Z të Komunës së Skenderajt e ka pre rrugën e Kryeministrit më qëllim sulmi. Dëgjova që disa gazetarë të Klan Kosovës, e kanë pyetur kryeministrin se po i përdor veturat zyrtare, ndoshta është më mirë me e pyet Samin se prej së cilës pompë të benzinës i ke komandu Huliganët e tu para se të nisesh si i frustuar”.

Në ankesë Anr.246/2025, pretendohet se me 28 janar 2025, kandidati për deputetë nga radhët e LVV z. Dimal Basha ka publikuar në status në njëjtin e tij social në facebook në të cilin shkruan: Vota për PDK është vetëm fuqizim për Sami Lushtakun e që Kosovës nuk i duhen më politikanë që sillen si



bandita. Kosova nuk i duron më Banditat. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur statusi i publikuar në profilin e z. Dimal Basha në rrjetin social Facebook.

Në ankesën 248/2025, pretendohet se me 27 janar 2025 në tubimin e mbajtur në Komunën e Skenderajt janë publikuar disa fotografi, në rrjetet sociale dhe mediat elektronike të mbështetësve të LVV, të mbledhur në këtë tubim, duke ngritur tre gishta lartë, gjest i cili është simbol ekskluziv serb, i cili në tre vitet e fundit ka marr ngjyrimet nacionaliste, pasi u përdor nga forcat paramilitare serbe në luftërat e zhvilluara në Ballkan. Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur Fotografia e publikuar nga tubimi i mbajtur në Komunën e Skenderajt, dhe ftesën e njoftuar nga subjekti politik LVV, për tubimin në Komunën e Skenderajt.

Në ankesën Anr.249/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 kandidatja për deputete nga radhët e LVV, znj. Fitore Pacolli ka postuar në profilin e saj në facebook Video incizim më përmbajtje të gjuhës urrejtëse ndaj subjektit politik PDK duke deklaruar se *"...Turma e madhe e qytetareve kishin dal në mbështetje të Kryeministrit Kurti, e ca huliganë të angazhuar nga PDK-ja, tentuan ti ndalojnë. Por ja që qytetarët e Skenderajt kanë vendosur ndryshe e do të vendosin ndryshe pra kësaj radhe ata do votojnë për Qeverinë më të mirë që ka pasur Kosova, pra qeverinë Kurti. Ata nuk janë peng i liderëve që kërcënojnë e i shantazhojnë për interesat e tyre politike.*

Në ankesën Anr.250/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 mbështetësi i subjektit politik LVV, aktualisht asistent personal i ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes z. Afrim Berisha ka publikuar një status në profilin e tij në facebook në të cilin shkruan *"Mjeranët e bandave të PDK-së, njëzëri u përgjigjen: Familjes Jashari atyre po u shesim trimëri. Bandat e PDK-së, i kanë varfëruar qytetarët në Drenicë, prandaj i manipulojnë e po i përdorin për interesat e tyre. Pyetni bandat pasi jeni kaq të fortë se si është e mundur që midis Drenice të ketë komunë paralele serbe, si është e mundur që asnjë organizim asnjë protestë nuk u organizua për largimin e tyre, se për gjuajtje të kallashnikovit as që bëhet fjalë. Pyetni Bandat e PDK-së pse u dashtë të vijë Albin Kurti në pushtet për tua larguar Beogradin nda dera e shtëpisë. Pyesni bandat nëse mund të përgjigjen.....Nuk ka banda të kujtdo qofshin që mund të ndalin fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Kryeministrit Albin Kurti".*

Në ankesën Anr.257/2025, pretendohet se më datë 27 janar 2025, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik LVV, aktualisht ministre në Ministrinë e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka deklaruar: *"...ani pse Qeveritë e kaluara thirrshin në emër të luftës, asnjëherë nuk bënë asgjë për luftën, përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës sepse Kosova ska bëre krime lufte por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar, por edhe nga Drenasi iu kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, të kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika, sepse qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen, më Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelët siç kishte amnisti në të kaluarën".*

Në ankesën 258/2025, parashtruesi i ankesës pretendon se me datë 27 janar 2025, kandidati për deputet nga radhët e LVV, aktualisht ministër i Ministrisë së Bujqësisë z. Faton Peci në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim ka deklaruar: *"Me datën 9 shkurt Kosova ka dy opsione para vetës. Edi se presioni është i madh dhe mediatik edhe i atyre të cilët po fusin me investimet e fundit krejt parat e pista për të parandaluar dhe njëherë Albin Kurtin të fitojë".*



vetëm bashkë me Guxo dhe Alternativën mandatin e ardhshëm të Qeverisjes dhe rrjedhimisht janë duke realizuar një presion të paparë cep më cep të Kosovës por këtë presion cep në cep të Kosovës nuk e bëjnë që Kosovën ta kenë shtet me sovranitet cep më cep, por se ata kanë mbetur keq në xhepat e tyre atje ku kanë dashur me nda copë më copë. Rrjedhimisht unë mendoj që Drenica e heroizmit, sakrificës, flijimit por edhe e krenarisë nuk do ti besoj atyre që e kanë konsideruar dhe e vlerësojnë veriun e Kosovës si dhuratë e Rankoviqit.

Në ankesën Anr.267/2025, pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 00:57 Selviqe Berisha mbështetësja e subjektit politik Vetëvendosje, anëtarë e LVV-së që nga 12 dhjetori 2024 ka shpërndarë një fotografi në grupin Vetëvendosje, në rrjetin social facebook me tekst shoqërues: *“Kur po ju them që Sami Lushtaku është kriminel dhe mafioz ju po më Shani në privat. Vota për Bedriun është shpëtim për Saminë”*.

Në ankesën Anr.268/2025 pretendohet se me datë 28 janar 2025 në ora 19:45 mbështetësja e subjektit politik LVV, aktualisht Koordinatore e Komuniteteve në Lëvizjen Vetëvendosje znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrjetin social facebook në të cilin shkruan: *“a shkoj sot në Klinikë të Epërme të Skenderajt, kandidati i PDK-së Bedri Hamza “Me Saminë bashkë a vetëm? Ende asnjë distancim nga huliganizmi i drejtuar nga Sami Lushtaku, as shtabi i PDK-së as kandidati i PDK-së. Programi “treni elektrik” realiteti banditizmi”*.

Më datë 29.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik LVV për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 30.01.2025 në ora 13:00.

Me datë 30.01.2025, subjekti politik LVV, ka parashtruar përgjigje në ankesë, në të cilën theksohet si në vijim:

Në përgjigjen për ankesën Anr.244/2025 të datës 30.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, thekson se ankesa është e pabazuar për faktin se e njëjta nuk përmban ndonjë fakt apo provë që ndërlidhet me shkeljen e pretenduar, si dhe e njëjta nuk është drejtuar subjektit konkret në këtë rast PDK-së, andaj PDK vetë aludon në vetveten kur përmendet korrupsioni. Pra z. Kurti në deklaratën e tij në asnjë çast nuk thekson subjektin e pretenduesit, në këtë rast PDK-së.

Në përgjigjen për ankesën Anr.245/2025 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV të njëjtën e ka vlerësuar si të pabazuar me pretendimin se nuk përmban ndonjë fakt i cili do ta ndërlidhte deklaratën/veprimin e përshkruar si shkelje dhe se deklarata e znj. Haxhiu, në llogarinë e saj në facebook është vetëm përshkrim i një situatë e cila u pengua nga aktivistë të PDK-së, për mbajtjen e tubimit dhe lëvizjen e lirë të Kryeministrit më eskortën shoqëruese.

Në përgjigjen për ankesën Anr.246/2025, të subjektit politik LVV, e njëjta e ka refuzuar si të pabazuar për faktin se njëjta nuk përmban shkelje me pretendimin se Sami Lushtaku me mbështetës tjerë të PDK-së, kanë çrregulluar tubimin e LVV-së, në Skenderaj, kanë kërcënuar qytetarët brenda tubimit të LVV-së, dhe se lidhur me këtë ka fakte siç është fakti i arrestimit të personit Lavdim Jashari përkrahës i PDK-së. Pra deklarata e kandidatit Basha në llogarinë e tij në facebook, e ardhur pas veprimeve të lartcekura të mbështetësve të PDK-së, nuk është asgjë tjetër pos një përshkrim i një



situatë të shoqëruar me veprimet penguese të këtyre anëtarëve dhe aktivistëve të subjektit përkatës PDK për mbajtjen e tubimit.

Në përgjigjen për ankesën 248/2025 të LVV-së, pretendohet se shkrimi i bashkangjitur në fotografi nuk dëshmon asgjë as vendin as personin që do të ndërlidhte me subjektin LVV, madje për një vrojtues të rëndomte ndoshta mund të dakordohemi se vetëm një flamur vërehet mirëpo asgjë tjetër lidhur me gjendje faktike.

Në përgjigjen për ankesën Anr.249/2025, të subjektit politik LVV, theksohet se deklarata e kandidatës në llogarinë e saj në facebook është në përputhje me rregullativën zgjedhore, ishin aktivistët dhe mbështetësit e PDK-së, ata të cilët kanë çrregulluar tubimin e LVV-së, në Skenderaj duke kërcënuar qytetarë brenda tubimit të LVV si provë është edhe fakti i arrestimit të mbështetësve të PDK siç është Lavdim Jashari.

Në përgjigjen për ankesën Anr.250/2025, të subjektit politik LVV, theksohet se deklarata e kandidatit në llogarinë e tij në facebook është në përputhje me rregullativën dhe frymën e një fushate zgjedhore. Mbështetësit dhe aktivistët e PDK-së, kanë çrregulluar tubimin e LVV, në dhe lidhur me këtë tashmë ka fakte siç është arrestimi i mbështetësve të PDK-së. Pra sipas parashtresit të përgjigjes në ankesë deklarata e këshilltarit Berisha nuk është gjë tjetër veçse përshkrimi i një situatë.

Në përgjigjen për ankesën Anr.257/2025 të subjektit politik LVV theksohet se sa i përket deklaratës *“Përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës, sepse Kosova ska bërë krime lufte, por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar por edhe nga Drenasi, u kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, të kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika sepse qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen, Ministra vetëm ka theksuar një fakt dhe një të vërtetë dhe një deklaratë të dhënë më parë nga vet Sekretarja e PDK-së znj. Vlora Çitaku, jo vetëm njëherë por shumë herë lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale e Cila kishte deklaruar se janë edhe ndjeshëm të mashtruar. Ndërsa sa i përket deklaratimit “me Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelet, siç kishte amnisti në të kaluarën” e njëjta vetëm se e rithekson një veprim dhe fakt të subjektit përkatës politik.*

Në përgjigjen për ankesën Anr.258/2025 të subjektit politik LVV, ka theksuar se Ministri Peci, në tubimin e mbajtur në Komunën e Drenasit ka përmendur fakte të cilat janë të ditura dhe të përmendur nga vetë subjekti përkatës PDK, këto deklarata të cilat tashmë janë deklarata notore nga vet akterë të rëndësishëm të këtij subjekti PDK-së Hashim Thaçi.

Në përgjigjen për ankesën Anr.267/2025, lidhur me pretendimet se personi i ashtuquajtur Selvije Berisha, është një mbështetëse dhe aktiviste e Lëvizjes VETEVENDOSJE! konfirmojmë si LVV, se personi i tillë nuk figuron si anëtarë apo aktivistë/mbështetëse e LVV-së. Për në shumë, bazuar në provat e ofruara nga pretenduesi, në asnjë moment nuk vërehet se llogaria e tillë në facebook, të jetë si llogari reale e personit në fjalë dhe e cila do të ndërlidhej me shkeljen e supozuar të parashtresues.

Në përgjigjen për ankesën Anr.268/2025 në pjesën e parë të këtij postimi Znj. Dejana Mihalica thënë: *“A shkoi sot në Klinë të epërme të Skenderaj, Kandidati i PDK-së Bedri Hamza? Me Saminë bashkë*



a vetëm”, e ka ngritur pyetjen e cila në vetvete nuk përmban asnjë nga veprimet e ndaluara në bazën ligjore të cekur nga ankuesi, konkretisht neni 34 par. 1 nën par 1.11 të LZP-së, që për bindjen e lirë dhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Neni 40), e njëjta ka të drejtë të aludoj se z. Bedri Hamza nuk shkon në bastionet e PDK në Skenderaj pa Sami Lushtakun që i përket me prejardhje asaj ane të Kosovës.

Në pjesën e dytë Znj. Dejana Mihali shprehet: *“Ende asnjë distancim nga huliganizmi i drejtuar nga Sami Lushtaku as shtabi i PDK-së as Kandidati i PDK-së”*, ku ka kërkuar distancim nga subjekti politik PDK për veprimet të cilat nga indiciet e forta lënë hapësirë për dyshim se kanë ndodhur pikërisht nga përkrahësit e PDK (fjala është për incidentin në Skenderaj për të cilin është në dijeni edhe PZAP për shkak të shumë ankesave nga subjektet lidhur me këtë ngjarje), pra Znj. Mihali kërkon që ky subjekt të distancohet dhe të vetë deklarohet se nuk kanë të bëjnë me ngjarjen, konsiderojmë se edhe kjo pjesë e deklaratës së zonjës Mihali është legjitime dhe e drejtë e saj që të kërkojë nga një subjekt i certifikuar nga KQZ dhe që përfaqëson një pjesë të popullatës në Kuvendin e Kosovës, që të distancohet nga veprimet banditeske ashtu siç ajo i ka quajtur dhe ashtu siç ato veprime në të vërtetë edhe janë. Deklarata (postimi) objekt i kësaj anekse, nuk është i drejtuar nga PDK, por është i drejtuar nga huliganët e natës së 27 janarit ku edhe ndodhi incidenti në Skenderaj.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, PZAP ka nxjerr vendimin Anr.244/2025, të datës 01.02.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe neni 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: Anr.244/2025, Anr.245/2025, Anr.246/2025, Anr.248/2025, Anr.249/2025, Anr.250/2025, Anr.257/2025, Anr.258/2025, të datës 29.01.2025 dhe Anr.267/2025, Anr.268/2025, të datës 30.01.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.244/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli vlerëson se gjuha e përdorur si më lartë nga kandidatët për deputet, mbështetësit dhe simpatizuesit e LVV-së është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektin politik PDK dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me neni 34 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik PDK, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se



deklarimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë polarizim të elektoratit, të krijojnë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes, të acaroj rivalitetin politik. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime apo deklarime që mund të sjellin pasiguri, destabilitet apo të përkeqësojnë atmosferën politike në përgjithësi, njëkohësisht janë të obliguar të respektojnë dinjitetin dhe integritetin e të tjerëve. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë. Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimet e tilla përbëjnë përsëritje të shkeljeve për nga natyra, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Duke pas parasysh se Rregullorja 01/2024 dhe dispozitat e LZP, neni 120 paragrafi 1 nën paragraf 1.3 për shkelje të tilla parashohin dënimin me gjobë deri në 50,000.00 Euro, Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë në mënyrë të përsëritur. Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon pjesërisht si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si në vendimin e tij, Anr.244/2025 të datës 01.02.2025 dhe e ndryshon pjesërisht për shkeljet e pretenduara lidhur me ankesat kontestuese dhe lidhur me dënimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Andaj nga gjendja si më lartë rezultojnë pjesërisht e bazuar ankesa e LVV lidhur me shkeljet ligjore përkitazi me aplikimin e nenit 34 par.1 nën par. 1.11 të LZP-së, lidhur me cilësimin e shprehjeve të përdorura nga subjekti politik, e që po ashtu kanë ndikim në lartësinë e dënimit me gjobë të shqiptuar dhe përputhshmërinë e tij, në proporcion me natyrën, shkallën dhe peshën e shkeljeve, si dhe rrethanat e tjera, andaj ankesa pranohet pjesërisht e bazuar dhe është ndryshuar pjesërisht vendimin e atakuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe pas shikimit të shkresave të lëndës, kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se pretendimet e ankuesit janë të qëndrueshme në raport me ankesat Anr.244/2025, Anr.257/2025 dhe Anr.258/2025, të parashtuara nga ana e subjektit



politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), këto ankesa të këtij subjekti politik refuzohen për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Gjykata vlerësoj se tri ankesat e refuzuara të PDK si në dispozitiv janë jo të qëndrueshme për faktin se, shprehjet: në ankesën, Anr.244/25, citim 1). *"..jemi duke i hequr qafe, duke i pensionuar, duke i eliminuar nga skena e pushtetit politikanët, himni i të cilëve nuk është rreth flamurit të përbashkuar, por rreth korrupsionit të përbashkuar, të dashur qytetare të Drenasit ata i ka bashkuar korrupsioni. Ata po i ndanë e po i përçan paraja e plaçkitur dhe zhvatur nga korrupsioni i tyre i përbashkët. Pra edhe një herë korrupsionin e kishin të përbashkët, por paraja po i ndanë e po i përçanë prandaj ata që ishin të pa besë janë bërë edhe të pashpresë"*. 2). Ankesa nr.257/2025 *"..ani pse Qeveritë e kaluara thirreshin në emër të luftës, asnjëherë nuk bënë asgjë për luftën, përveç që e votuan Gjykatën Speciale që dëmton interesat e Republikës së Kosovës sepse Kosova ska bëre krime lufte por Serbia. Tash po thonë që jemi mashtruar, por edhe nga Drenasi iu kërkojmë atyre që qenkan mashtruar, të kërkojnë falje për këtë dëm dhe të heqin dorë nga politika, sepse qytetarët nuk i duan politikanët që mashtrohen, më Kryeministrin Kurti nuk do të ketë amnisti për kriminelët siç kishte amnisti në të kaluarën"*; dhe ankesën, nr. A nr. 258/2025, citim *"Me datën 9 shkurt Kosova ka dy opsione para vetës. Edë se presioni është i madh dhe mediatik edhe i atyre të cilët po fusin me investimet e fundit krejt parat e pista për të parandaluar dhe njëherë Albin Kurtin të fitoj i vetëm bashke me Guxo dhe Alternativen mandatin e ardhshëm të Qeverisjes dhe rrjedhimisht janë duke realizuar një presion të paparë cep më cep të Kosovës por këtë presion cep në cep të Kosovës nuk e bëjnë që Kosovën ta kenë shtet me sovranitet cep më cep, por se ata kanë mbetur keq në xhepat e tyre atje ku kanë dashur me nda copë më copë. Rrjedhimisht unë mendoj që Drenica e heroizmit, sakrificës flijimit por edhe e krenarisë nuk do ti besoj atyre që e kane konsideruar dhe e vlerësojnë veriun e Kosovës si dhuratë e Rankoviqit. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate këto deklarime nuk paraqesin gjuhë denigruese dhe nuk nxisin urrejtje në raport me subjektin konkret ankues dhe nuk rezulton se janë në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11 të LZP-së.*

Për pjesën tjetër vendimi i PZAP sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme rezulton i bazuar, lidhur me shprehjet e përshkruara sikurse në ankesat A.nr.245/2025, A.nr.246/2025, A.nr.248/2025, A.nr.249/2025, A.nr.250/2025, A.nr.267/2025, A.nr.268/2025, ngase ka vlerësuar se shprehjet e tilla në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes, andaj për këtë, pjesë vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, e paraparë në nenin 34, par 1. nën par. 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24, pika 9.1 të Rregullores 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Kjo për faktin se PZAP,



vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese: si CD-video incizim - et, postimet në rrjetin social facebook, fotografitë, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se me këto veprime është shkelur Kodi i Mirësjelljes dhe në veçanti neni 34 par. 1 nën par. 1.11, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet se: *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*. Si rezultat i kësaj këto veprime të tilla vlerësohen se janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), për çka edhe me të drejtë subjektit politik në fjalë i është shqiptuar gjoba në pajtim me dispozitën e nenit 120 parag.1, nën paragrafi 1.3 të LZP-së.

Lidhur me lartësinë e dënimit me gjobë të shqiptuar, gjykata vlerëson se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara sikurse në arsyetimin e vendimit të ti, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50,000.00 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoba e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 35,000.00 (tridhjetepesëmijë) €, nuk është proporcionale, përkitazi me shkeljet e subjektit andaj pas ndryshimit të vendimit të atakuar, dhe refuzimit të ankesave sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të njëjtin e ndryshoj në lartësinë prej 25,000.00 (njëzetepesëmijë) €. Me dënimin e zbritur vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes.

Nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, nga gjendja faktike e vërtetuar nga PZAP si në vendimin e saj, pjesërisht është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj pretendimet ankimore janë aprovuar pjesërisht si te bazuara ndërsa vendimi i atakuar është ndryshuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË

AA.nr.32/2025, datë 05.02.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani

Funëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa: AA-32/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjete në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lapërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në bancesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqut, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određenom vremenu u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në bancesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e bancesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stani - radnom mestu primaoca (pribicno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____
Shkak i refuzimit të marrjes _____
Razlog ardhja prijnea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaoca

(Të panevojshme bjeri vizë - nepotrebnje precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

ARTIKULI 55.05.2025

Numri i shlojave: 1

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Poviduemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima)

16.20
(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij)
Polpis primioa ili lica koje je pismeno primilo u zameni

Nënshkrimi i dorëzuesit - polpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është gjetur ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Në rast se marrësi është gjetur ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Në rast se marrësi është gjetur ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Në rast se marrësi është gjetur ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.